

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**ARK-AM CONSTRUCTION sh.p.k.**

**Ne kete statut:**

- **“Ligji”** eshte Ligji Nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar
- **“Statuti”** eshte statuti i Shoqerise

**KREU 1**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA, KAPITALI**

**NENI 1**

**THEMELIMI DHE TE DHENAT IDENTIFIKUESE TE THEMELUESIT**

1.1 Themeluesi me vullnetin e tij te lire, për arritjen e objektivave ekonomikë, duke dhënë kontributin e tij, ka krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **ARK-AM CONSTRUCTION sh.p.k.** e cila krijohet dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar,

1.2 Themelues i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte:

- **Z. ARBLIN KARAJ**, shtetas shqiptar, atesia Bajram, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga leternjoftimi me NID I50813035C.

**NENI 2**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

2.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte “Punime per prishjen e ndertimeve, punime germimi ne toke, rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash, mirembajtjen e tyre, punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale. Ndertime civile dhe rezidencash banimi, ndertime parafabrikat, betonarme, struktura metalike dhe druri. Impjante hidrosanitare, Impiante te brendshme elektrike, telefonie, radiotelefoni, TV, shitblerje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, materialesh ndertimi etj.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

3.1 Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat.

**NENI 4**

**SELIA E SHOQERISE**

4.1 Selia e shoqerise/Zyra qendrore ndodhet brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne adresen: Tirane, Kashar, Rruga "Teodor Keko"Banesa Nr.3 – D, Shkalla 3, Kati i pare.

## **NENI 5**

### **KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i ortakeve te shoqerise eshte i shprehur ne monedhen Lek. Ortaku i vetem ka vendur qe kapitali i nenshkruar i saj te jete 100 000 (njqind mije) Lek, i ndare ne 1 kuote e cila ka vleren 100'000 Lek.

5.2 Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

- Ortaku themelues Z. ARBLIN KARAJ, eshte kontribues ne vleren 100'000 Lek dhe si rrjedhim zoterues i 1 kuote me vlere 100'000 Lek qe perben 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

5.3 Ortaku themelues deklaroi se do te shlyej kapitalin e regjistruar brenda 30 diteve nga hartimi i ketij statuti duke e depozituar ate ne llogarine bankare te hapur ne emer te shoqerise se krijuar;

## **NENI 6**

### **MODALITETET E ZMADHIMIT, ZVOGELIMIT DHE TRANSFERIMIT TE KAPITALIT**

6.1 Kapitali zmadhohet ose zvogelohet kur ploteson kushtet ligjore dhe duke ndjekur procedurat e parashikuara ne ligj ne momentin e vendosjes se zmadhimit ose zvogelimit te tij.

6.2 Kuota e shoqerise transferohet sipas parashikimeve te ligjit duke u marr me pare miratimi i Asamblese se shoqerise.

## **KREU 2**

### **ORGANET VENDIMMARRESE/DREJTUESE/ADMINISTRUESE**

## **NENI 7**

### **ORGANI VENDIMMARES I SHOQERISE**

7.1 Organi i vetem vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e pergjithshme e ortakeve.

7.2 Asambleja e ortakeve mblidhet sa here eshte e nevojshme per mbarevajtjen e shoqerise por jo me pak se 3 here ne vit.

7.3 Asambleja e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;




- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin apo shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin apo shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi apo statuti.

7.4 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 7.3 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

7.5 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

7.6 Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike te cilet duhet te permbajne vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe jo me vone se 10 dite nga dita e zhvillimit te mbledhjes se asamblese.



## NENI 8


### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

8.1 Te dhenat e identifikimit te administratorit te Shoqerise dhe specimenet e nenshkrimit jane :

Te dhenat e identifikimit:

- **Z. ARBLIN KARAJ**, shtetas shqiptar, atesia Bajram, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga leternjoftimi me NID I50813035C.

**Specimenet e nenshkrimit:**




## NENI 9

### EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

9.1 Administratori i shoqerise emerohet me vendim unanim te Asamblese se ortakeve per nje periudhe 5-vjecare me te drejte riprteritje. Shkarkimi i administratorit behet me vendim unanim te asamblese se ortakeve.

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare ne marrëdhënie me te tretet;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe legjislacionin ne fuqi.



e) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;  
ë) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

#### **NENI 10**

#### **BAZA LIGJORE**

Shoqeria është krijuar dhe do të zhvillojë veprimtarinë ekonomike në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, legjislacioni tatimor dhe çdo ligj tjetër specifik që lidhet me aktivitetin e shoqërisë.

#### **NENI 11**



#### **MOSMARREVESHJET**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i këtij statuti si dhe për mosmarreveshjet midis shoqërisë dhe të tjerëve do të jenë kompetente gjykata e shqiptare sipas legjislacionit në fuqi.

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

#### **ARK-AM CONSTRUCTION SHPK**

**ARBLIN KARAJ**

Nenshkruar në Tiranë më, 09/09/2020

